

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
SEKTORI I MARRËDHËNIEVE ME BORDIN E AKREDITIMIT DHE
NDËRKOMBËTARIZIMIN

Nr. 55 Prot.

Tiranë, më 5.01.2024

LËNDA: Përcillen vendimet e Bordit të Akreditimit

KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"
Rruga "Dritan Hoxha", Pallatet Komfort,

TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të radhës, të mbajtur më datë 25 Nëntor, mori vendime që lidhen me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit të disa programeve të studimit.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, vendimet e Bordit të Akreditimit Nr. 178 dhe 179, datë 25.11.2023.

Gjithashtu, Ju bëjmë me dije se vendimet janë publikuar në faqen zyrtare të internetit të ASCAL.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

XBY
Xhiliola Bixheku

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 179, datë 25.11.2023

PËR

AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË
BACHELOR NË "MENAXHIM TURIZMI", TË KOLEGJIT UNIVERSITAR "LOGOS"

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 531, datë 11.9.2018, "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 "Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit", në mbledhjen e tij të datës 25.11.2023, në kuadër të vendimarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në "Menaxhim Turizmi", me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në "Menaxhim Turizmi"
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës nr. 1055, datë 29.07.2009
- d) Akreditimi periodik: Vendim i Bordit të Akreditimit nr. 48, datë 05.07.2019
- e) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar "Logos"
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti i Menaxhimit
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- h) Kredite (ECTS): 180 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar "Logos"
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga akreditimi periodik;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta e afirmimet dhe pikat e dobëta, të identifikuara e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në institucion;
- e. Rezultati i akreditimit periodik të këtij programi ka qënë pozitiv, me rekomandime;
- f. Institucioni ka përmbushur rekomandimet e lëna nga akreditimi periodik;
- g. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësisë të *“Standardeve për sigurimin e cilësisë për programet e studimeve të ciklit të parë “Bachelor”*” dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit, është **“i përmbush kryesisht standardet”**, me mangësitë si më poshtë:
 1. Mungesa e përfshirjes në planin mësimor të këtij programi studimi e të paktën një lëndë për bazat e turizmit që të japë konceptet bazë të turizmit që në fillimet e studimit të programit.
 2. Mungesa e lëndëve me zgjedhje në planin mësimor të këtij programi studimi.
 3. Numër i ulët i personelit akademik me kohë të plotë i angazhuar në këtë program studimi, me specializim në turizëm.

Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit Bachelor në **“Menaxhim Turizmi”**, të Kolegjit Universitar **“Logos”**.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **24.11.2027**.

4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve të Kodit të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas shtojcës bashkëlidhur.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

SHQIPONJA TELHAJ		Kryetare
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
AYŞEN SAVAŞ SARGIN		Anëtar
TOMASZ JELENSKI		Anëtar
IRAJ HASHI		Anëtar
MAURICE OUDEJANS		Anëtar
LEA YPI		Anëtar
KITA SALLABANDA DIAZ		Anëtar
DARINKA PIQANI		Anëtar
DRITAN NAÇE		Anëtar

INDRIT HOXHA



Anëtar

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 179, datë 25.11.2023, “Për akreditimin periodik të programit të studimit Bachelor në “**Menaxhim Turizmi**”, të **Kolegjit Universitar “Logos**”, janë si vijon:

1. Institucioni, të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi, duke përfshirë në të, të paktën një lëndë për bazat e turizmit, si përsëmbull “Baza Turizmi”, “Manaxhim i Turizmit të Qëndrueshëm”.
2. Institucioni, të bëjë pjesë të planit mësimor të këtij programi studimi lëndët me zgjedhje duke përfshirë lëndë bashkëkohore që përkojnë edhe me tendencat e fundit të turizmit dhe ndikimit të tij.
3. Institucioni, të marrë masa për shtimin e numrit të personelit akademik me kohë të plotë të angazhuar në këtë program studimi, i specializuar në turizëm.
4. Institucioni, të marrë masa për shtimin e literaturës së viteve të fundit, në funksion të këtij programi studimi.
5. Institucioni, të shohë mundësinë e vendosjes së aplikacioneve specifike në laboratorin e informatikës me qëllim realizimin e disa orëve sa i përket teknologjisë së informacionit dhe sistemeve të rezervimit.

Në përmbushje të rekomandimeve të mësipërme, **Kolegji Universitar “Logos**”, duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret dhe ta dorëzojë atë brenda 6 (gjashtë) muajve pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 47, datë 05.07.2019

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË,
BACHELOR NË “MENAXHIM BIZNESI”, TË KOLEGJIT UNIVERSITAR “LOGOS”

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80 datë 17.09.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për Funkcionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike”, Ligjin Nr. 44/2015, datë 30.04.2015, “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, “Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, “Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit”, dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. Ekstra 1, datë 02.02.2018 “Për miratimin e Rregullores së Bordit të Akreditimit”, në mbledhjen e tij të datës 05.07.2019, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i programit: Bachelor në “Menaxhim Biznesi”
- b) Cikli i studimit: Cikli i parë
- c) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 1, datë 06.01.2011
- d) Akreditimi i parë: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 282, datë 04.07.2012
- e) Institucioni që e ofron: Kolegji Universitar “LOGOS”
- f) Njësia bazë përgjegjëse: Departamenti Menaxhim Biznesi
- g) Kohëzgjatja (Vite/semestra): 3 vite / 6 semestra
- h) Kredite (ECTS): 180 kredite
- i) Forma e studimit: Me kohë të plotë
- j) Statusi i diplomës: ofrohet vetëm nga Kolegji Universitar “LOGOS”
- k) Niveli i diplomës në kuadrin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve: Niveli 6

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e programit të studimit;
- b. Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- c. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- d. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e jashtëm në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- e. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- f. Komunikimin e vërejtjet e Institucionit në kuadër të këtij procesi;
- g. Raportin e vlerësimit dhe rezultatet e akreditimit të parë për këtë program studimi;
- h. Shkallën e përmbushjes së rekomandimeve të lënë në kuadër të akreditimit të parë;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në këto akte;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimit të Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në Institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet, pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe pengesat, të identifikuar e verifikuar përmes dokumentacionit dhe vizitës në Institucion;
- e. Rezultati i akreditimit të parë të këtij programi ka qenë Pozitiv me rekomandime;
- f. Prej katër rekomandimeve të lëna nga akreditimi i parë, Institucioni ka përmbushur një, ka përmbushur kryesisht dy dhe ka përmbushur pjesërisht një rekomandim;
- g. Rezultati i vlerësimit në lidhje me shkallën e plotësimin të Standardeve Shtetërore "*Për vlerësimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë*" dhe cilësinë e ofertës akademike të programit të studimit është "**i përmbush pjesërisht standardet**", me mangësinë si më poshtë:
 - i. Mungesa e balancës ndërmjet lëndëve me karakter financiar dhe të menaxhimit dhe mungesa në kurrikulë e disa lëndëve të rëndësishme të fushës;
 - ii. Mungesa e detyrave të kursit në lëndët ku aftësimi praktik është shumë i rëndësishëm;
 - iii. Në disa raste, fusha e ekspertizës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi nuk është tërësisht në përputhje me lëndët që mbulon;
 - iv. Numri i kufizuar i titujve në bibliotekë, sidomos botime të viteve të fundit, në funksion të programit të studimit.









Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. Vlerësimin Përfundimtar **POZITIV** për programin e studimit **Bachelor** në **“Menaxhim Biznesi”**, të **Kolegjit Universitar “LOGOS”**, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij Vendimi.
2. **Akreditimin** e programit të studimit me kohëzgjatjen prej **3 (tre)** vite akademike.
3. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të programit të studimit është **30/09/2022**.
4. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin për ruajtjen në vijim të Standardeve Shtetërore të Cilësisë dhe plotësimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA		Kryetar
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
FABRICE HENARD		Anëtar
ARBEN MERKOZI		Anëtar
ALEKSANDËR XHUVANI		Anëtar
ANILA PAPARISTO		Anëtar
SULO HADERI		Anëtar
LULJETA MINXHOZI		Anëtar

MYFTAR BARBULLUSHI

Anëtar

ILIR PANDA



Anëtar

FATMIR GURI



Anëtar

Shënim: Z. M. Barbullushi nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandimet në zbatim të vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 67, datë 05-07.2019, “Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë, Bachelor në “Menaxhim Biznesi”, të Kolegjit Universitar “LOGOS””, janë si vijon:

1. Institucioni, të rishikojë planin mësimor të këtij programi studimi me qëllim shtimin e lëndëve të karakterit menaxherial dhe formues si dhe përfshirjen në plan të disa lëndëve të rëndësishme si psh. Menaxhim projekti; Sjellje organizative; Shkrim akademik, etj.
2. Institucioni, të parashikojë në planin mësimor të këtij programi studimi, detyrën e kursit si një nga format e mësimdhënies.
3. Institucioni, të sigurojë përputhshmërinë ndërmjet fushës së ekspertizës së stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi dhe lëndëve që ata mbulojnë në këtë program.
4. Institucioni, të pasurojë bibliotekën fizike dhe atë online me tituj të viteve të fundit, për të gjitha disiplinat, por sidomos për lëndët e menaxhimit dhe marketingut.
5. Institucioni, të mundësojë digjitalizimin e të dhënave të stafit akademik dhe studentëve si dhe ndërtimin e një platforme për informimin e studentëve.

